

VENDIM
Nr.544, datë 9.8.2006

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURISË SË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REHABILITIMI I KOLEKTORIT TË UJËRAVE
TË BARDHA, NË QYTETIN E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kolektorit të ujërave të bardha, në qytetin e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe tokë truall 2 000 m² me vlerë të përgjithshme 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë të përballohen nga bashkia e Shkodrës.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 1.10.2006.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I KOLEKTORIT TË
UJËRAVE TË BARDHA NË QYTETIN E SHKODRËS**

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Bashkëpronarët					
2	Ferid Hamid Lluja	Nr.8/707	8591	2000 m ²	4500	9 000 000
3	Ferdi Hamid Lluja					
4	Lavdiqe Hamid Lluja					
5	Fitnete Hamid Lluja					

Vlera totale e këtij shpronësimi është 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.